Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson U.D. i Menaxherit- të Prokurimit z. Gëzim Ademaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te furnizimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

"MATKOS PHARM" e përfaqësuar nga z. Liman Buzoku, nga Prishtina, me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 811159624, ne vazhdim "FURNITORI", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për FURNIZIMET si më poshtë:

BLERJA E PAISJEVE MJEKSORE STOMATOLOGJIKE PËR QKMF- ISTOG

Nr. I prokurimit	**633-20 - 6957-1-2-1/ C 341**
Nr. I brendshëm	**633 / 020/ 114 / 121**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësajë kontrate publike është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzmin e mallrave si në vijim:

BLERJA E PAISJEVE MJEKSORE STOMATOLOGJIKE PËR QKMF- ISTOG

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË DHE DO TE PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME **31.12.2020** NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjën e te gjitha **FURNIZIMEVE** do të jetë: **31.12. 2020** si afat I skadimit te kontratës.

2.2 Vendi ku do te dorëzohen artikujt do të jenë **INSTITUCIONET KOMUNALE TE ISTOGUT, respektivisht do te caktohet nga Drejtorati për Shendetësi.**

2.3. Obligimet e kontrakorit janë te gjitha furnizimet të percaktuara ne Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve te pergjithshme dhe te veqanta te kontratës.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP[1] (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Kryersi I furnizimeve duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të tyre. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi:

4.1 Blera kontraktuese e aktivitetit te Prokurimit "**BLERJA E PAISJEVE MJEKSORE STOMATOLOGJIKE PËR QKMF- ISTOG**

Vlera e përgjithshme e kontratës për periudhën **deri me 31.12.2020** është: ***8.634,00*** **Euro. Dhe me shkronja: /Tetëmijëegjashtëçindetridhjetekatërzerozeroeuro.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'I nënshtrohen ndryshimeve për porosit e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Kontrata Publike Kornizë;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

(f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet

të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut:

Për Furnizuesin:

"MATKOS PHARM" Shpk

Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Limon Buzoku***
Pozita:	***U.D. i Menaxherit Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	04.12.2020	***Data:***	04.12.2020
Vula:		***Vula:***	

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPSTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

SH. P. K. MatkosPharm PRISHTINE

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	8.1	SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS ËSHTË 10 % E VLERES SE PARASHIKUAR TE KONTRATËS NE AFAT PREJ 3MUAJSH
Sigurimi	9.1	
Cilësia e furnizimeve	16.2	CILESIA DHE KUALITETI-DUHET TE JENE NE PERPUTHJE TE PLOTE ME SPECIFIKIMET E DETYRUESHME TEKNIKE – ANEKS I KONTRATËS
Inspektimi dhe testimi	17.2	**INSPEKTIMI DHE TESTMI I MATERIALEVE DO TE BEHET PERMES ORGANEVE KOMUNALE – MODALITETET DO TI VENDOS NJËSIA E IMPLEMENTIMIT TE KONTRATËS.**
Dorëzimi	19.3	*DOREZIMI I MATERIALEVE BEHET, SIPAS SPECIFIKACIONIT TE DREJTORATIT PERKATËS.*
Obligimet e garancionit	22.1	*N/A*
Shërbimet pas shitjes	23.1	*N/A*
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	*ÇDO MOSMAREVESHTJE EVENTUALE TE CILAT MUND TË LINDIN. DO TE ZGJIDHEN NË MËNYRË MIQESORE – NGA ORGANET KOMUNALE – DREJTORATI PERKATES*
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Në GJYKATEN THEMELORE – DEPARTAMENTI PER ÇASHTJE EKONOMIKE - PRISHTINË ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh

KOMUNA E ISTOGUT					
PAISJE MJEKËSORE					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
3	**Paisje dentare**				
1	Autoklav per sterilizim B Class 23 Litra me cikle te paraprogramuara Sistemi per pastrimin e ujit dhe osmoze I integruar Autokllavi me printer , Destilator dhe Paketim ISO dhe EC e prodhuesit ISO e operatorit ekonomik	copë	1	1,500.0 €	1,500.0 €
2	**Vitalion** për përcaktimin e vitalitetit të pulpes me bateri	copë	1	30.0 €	30.0 €
3	**Karrige stomatologjike komplet** Prodhim Modeli : BE 2020 Turbina me drite Kundërkand dhe pjesament Kavitron dhe maja komplet Kamerë dhe monitor SAMSUNG Dy boca për ujin Reflektori Kirurgjik I integruar me 6 drita Karriga për stomatologun 2	copë	1	1,800.0 €	1,800.0 €
4	**Heliomat** Me tre programe operimi Wireles dhe me kabull	copë	2	50.0 €	100.0 €
5	**Endometër me Apex Locator** LCD Display color Wireles dhe me aksesore shtesë	copë	1	500.0 €	500.0 €
6	**Sete për ekzaminimin stomatologjik** Tasne e thellë , Sonda , Pinceta,Eskavator set	copë	30	15.0 €	450.0 €
7	**Sete të danave stomatologjike** Për të rritur 10 dana njëset me kuti mbajtese	copë	16	70.0 €	1,120.0 €
8	Sete të llozave për nofullen e siperm	copë	16	4.0 €	64.0 €
9	Sete të llozave për nofullen e poshtme	copë	16	4.0 €	64.0 €
10	Turbina 4 vrima BE	copë	10	60.0 €	600.0 €
11	Kunderkand BE	copë	10	40.0 €	400.0 €
12	Aparat Cavitron për heqjen e gurëzve I jashtëm montues LED	copë	2	100.0 €	200.0 €
13	Enë Pjetri me ndamje	copë	16	6.0 €	96.0 €
14	Box për instrumente gracile	copë	16	10.0 €	160.0 €
15	Boca të Oksigjenit 10 lit. me Nanometër- me bocë me barometër	copë	10	110.0 €	1,100.0 €
16	Boca të Oksigjenit 5 lit. me Nanometër- me bocë me barometër	copë	5	80.0 €	400.0 €
17	Varëse për Infuzione	copë	10	5.0 €	50.0 €
	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT				8,634.0 €

SH.P.K.